

**PORTI DETAR SHA  
SARANDE**

**NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. 429/1.Prot.

Sarande më, 30.07.2023

**PROCESVERBAL**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR  
KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**Objekti:** “Pajisje zyre dhe informatike”.  
**Procedura:** “E hapur e thjeshtuar”- Mall, (elektronikë).  
**Fondi limit:** 1,397,491(nje milion e treqind e nentedhjet e shtate mije e katerqind e nentedhjet e nje) lekë, pa TVSH. Burimi:  
**Vetëfinancim**  
**Afati:** 10 ditë.  
  
**Referenca:** Programi ekonomik i Shoqerise per vitin 2023.

**Përlllogaritje Fondi Limit nga Grupi i Punes nr.324,prot,dt.05.06.2023.**

**CPV: 30213200-7 Kompjuterë tabletë: 34421000 - 7 Motorë skuter: 30213300-8 Kompjuterë desktopë: 30121200-5 Pajisje fotokopjimi: 38650000-6 Pajisje fotografike: 39717200-3 Pajisje të ajrit të kondicionuar; 32552410-4 Modem; 44212250-6 Antena; 32421000-0 Kabllo rrjeti; 32422000-7 Komponentë të rrjetit**

**KODI OUTPUT: 0000000**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **PORTI DETAR Sha SARANDE** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formularin e ofertës sipas Shtojcës 1/1.

**Sigurimi i Ofertës:** Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", Neni 83: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës.

Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2% e fondit limit pa TVSH: 27 950 lekë (njëzet e shtatë mijë e nentëqind e pesëdhjetë mijë) monedha (e shprehur me fjalë).

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik.**

**2.1.1.** Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale.

Te jete i specifikuar ne QKB objekti i veprimtarise se operatorit ekonomik i njejte ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

Sipas percaktimeve te bera ne Shtojcen 7 te DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-ës.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën në njërin nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë **jo më e vogël se** 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

#### **Argumentimi:**

Bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43/pika 2(c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke qene lloji i procedures "Procedurë e hapur e thjeshtuar-mall", percaktimi i vleres se kerkuar eshte bere ne mbeshtetje te nenit 43, pika 2, germa "c" të VKM nr.285, dt. 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku percaktohet se:

*"Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:....."*

*b) 40% te vlerës se përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nen kufirin e ulët monetary.....";*

---

Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten

**2.2.2** *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 vitet e fundit financiare ,te miratuara, dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e kerkuara nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.*

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të ketij ligji.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes se kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.*

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

#### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat (furnizimet) e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, për furnizime të ngjashme të kryera tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*

**2.3.2.** Operatori ekonomik ditën e zhvillimit të tenderit duhet të paraqesë fizikisht mostrat për artikujt e tabelës së mësipërme, në përputhje me Specifikimet Teknike të hedhura në SPE, të shoqeruara me (Skedat teknike).

#### **1. LAPTOP ADVANCE**

- Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit në ambjentet protokollit të AK.
- Cdo mostër e paraqitur pas orarit të përcaktuar për hapjen e procedurës nuk do të pranohet.
- Mostrat e kërkuara duhet detyrimisht të jenë të vëlosura me vulën e ofertuesit, emrin e ofertuesit, datën e zhvillimit të tenderit, të nënshkruara në vende të dallueshme dhe të ketë numrin rendor korespondues me emrin e artikullit.
- Mostrat duhet të përputhen me cilësimet e dhëna në specifikimet përkatëse. Nëse mostrat nuk janë sipas specifikimeve të AK-ës, OE do të skualifikohet.
- Mosparaqitja e mostrave, skedave teknike ditën e zhvillimit të tenderit është kusht për skualifikimin e operatoreve.

#### **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6 “a”, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar,

si dhe Udhezimit të APP-së Nr.3 datë 12.04.2022 “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë”.

Kriteri i vendosur për paraqitjen e mostrave është kërkuar për tu siguruar AK-ëja, për plotësimin e kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike ku mostra e kërkuar do të shfaqë cilësinë e produktit final i cili do të lëvrohet nga OE fitues gjatë gjithë zbatimit të kontratës.

### **2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqes *ISO 9001-2015*.**

Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas ISO/IEC 9001 2015 (për sistemin e menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalente. Për plotësimin e kësaj kërkesë ofertuesi duhet të paraqesë certifikatën Certifikatë ISO 9001:2015 (ose ekuivalente), Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

#### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 dhe (Standardet e sigurimit të cilësisë) të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40 dhe nenin 44(Kërkesat e cilësisë) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Me anë të kësaj kërkesë, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar me sukses

kontratën. Përbushja e standarteve ISO ose ekuivalent është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së mallrave që kategorizohen në kontratë.

Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi dhe besueshmerie për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës.

**2.3.4. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim të prodhuesit / Distributorit të autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kerkuara me poshte. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.**

### **1. LAPTOP ADVANCE**

#### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 PIKA 4 (Standardet e sigurimit të cilësisë) të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pika 6 në nenin 40 dhe nenin 44(Kërkesat e cilësisë) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Për të ritur sigurinë dhe bindjen e AK-es së ofertuesit janë të afte realizojnë kontratën në rast se shpallen fitues, për shkak të natyrës së vecante të artikullit objekt prokurimi dhe për të garantuar se oferta teknike është bazuar në produkt real të identifikuar nga ofertuesit.

Kriteri është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmerinë e OE ofertues për aftësitë teknike dhe të shërbimit AK-es për njohjen e mundësive të ofertuesve për përmbushjen me sukses të kontratës.

**Shënim:** Ne zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

*Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”*,

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas shkresës Nr.2065 Prot, datë 12.04.2022.

Në specifikimet teknike që janë hedhur në dokumentet teknike të tenderit nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

**Ato janë në formatin PDF me 7 faqe hedhur në SPE [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).**

### **NJËSIA E PROKURIMIT:**

Krenar BEDAJ

Thoma Thomagjini

Florjana JERONDATI